



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:007407
Datë: 22.02.2024
Numri i dokumentit: 05485640

C.nr.295/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. L. me vendbanim në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. A. K. nga Prishtina, kundër të paditurës Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK-së), në Prishtinë, lidhur me pagimin e shumës së mospaguar të 3 pagave dhe shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së seancës gjyqësore me datën 22.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A. L. me vendbanim në Prishtinë dhe DETYROHET e paditura Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK-së), në Prishtinë, që paditësit A. L. me vendbanim në Prishtinë t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 2,975.00€, gjegjësisht atë në emër të tri(3) pagave për shpërblim jubilar me vlerë prej 425.00€ shumën totale prej 1,275.00€ si dhe në emër të tri pagave përcjellëse prej 425.00€ shumën prej 1,275.00€ dhe një pagë të 13-të me shumën prej 425.00€ me kamatë prej 8 % e cila do të llogaritet prej datës 18.03.2024 kur është marrë ky aktgjykim e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 259.00 € në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

Paditësi A. L. me vendbanim në Prishtinë pranë kësaj gjykate me datë 21.01.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK-së), në Prishtinë, për kompensimin e shumës së mospaguar të 3 pagave dhe shpërblimit jubilar. Paditësi përmes të autorizuarit të tij në padi ka theksuar se sipas dispozitave të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive atij i takon e drejta në pagat jubilarë në vlerë prej 3 pagave mujore të tij dhe se i punësuari me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën e pagesës përcjellëse 3 paga mujore të cilat i ka marrë për 3 muajt e fundit. Prandaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi

padinë e paditësit dhe ta detyroj të paditurën që t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,975.00€, dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,275.00€ si dhe në emër të tri pagave jubilarë shumën prej 1,175.00€ dhe një page të 13-të në shumën prej 425.00€ me kamatë prej 8 % e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës gjatë seancës përgatitore ka theksuar se qëndron pranë përgjigjes në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Me tutje ka theksuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive të Kosovës në bazë të të cilës është kërkuar shpërblimi për pagat jubilarë dhe përcjellëse ka qenë në fuqi vetë gjatë periudhës 2015 – 2018 e që më nuk prodhon efekte juridike që nenkupton që nuk është në fuqi. E paditura e kundërshton edhe kërkesën për pagat e 13-ta si dhe pagat pas pensionimit, duke theksuar që sipas buxhetit të ndarë për paga dhe mëditje, QKUK që nga viti 2018 ka mungesë të buxhetit për paga dhe mëditje. Pra, në mungesë të buxhetit dhe nënkategorisë buxhetore e paditura nuk mund të bëjë përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga kjo kontratë.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: Vërtetimi e datës 31.01.2020, Kontratën nga marrëdhënia e punës Nr.3558, Lista e pagës për paditësin dhe qarkullimin bankar të tij, Pasqyra e llogarisë së trustit për paditësin. janar 2019 dhe kopjen e librezës së punës me numër të regjistrimit 41605.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e provave, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet si në vijim:

Midis palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë e punësuar tek e paditura në vendin e punës në departamentin e Shërbimeve Teknike të QKUK-së.

Midis palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka 37 vite përvojë pune. Kjo vërtetohet edhe nga vërtetimi i datës 13.01.2020 si dëshmi për përvojën e punës, me të cilin vërtetohet data e fillimit të marrëdhënies së punës së të paditurit te e paditura.

Nga lista e pagës së paditësit dhe qarkullimi bankar i tij, Gjykata vërtetoi se paga bazë e paditëses në tre muajt e fundit para pensionimit ka qenë 485.55€, mirëpo Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për faktin se nuk mund të i tejkaloj kërkesat e palëve.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj).

Neni 4 paragrafi 1 i KKS përcakton se: “KKS-ja gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”.

Me nenin 17 paragrafi 5 të KKS parashihet se: 1. Paga e të punësuarit rritet për çdo vit të plotë të stazhit të punës në lartësi prej 0,5% mbi pagën bazë në pajtim me Marrëveshjen Kolektive të Përgjithshme të Kosovës. 2. Punëmarrësi mund të kompensohet me pagësn e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit. 3. Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 4. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf. 5. Kompensimi në rast të pensionimit, i punësuarit me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t’ia paguaj tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri paga në emër të shpërblimit jubilar. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 17 paragrafi 5 të KKS-së e cila është dhe ka qenë e zbatueshme edhe në kohën kur është pensionuar paditësi. Për më tepër në momentin e pensionimit i njëjta ka pasur më tepër se 30 vite përvojë pune të pandërprerë, pra ka mbushur vitet e nevojshme të përvojës së punë për shpërblim jubilar sipas nenit 17 paragrafi 3 pika 3 e KKS-së.

Lartësia e kërkesëpadisë për tri paga përcjellëse për në pension dhe tri paga jubilarë dhe pagën e 13-të është bazuar në pagën mujore mesatare neto të realizuara nga paditësi në tre muajt e fundit.

Kështu, Gjykata duke u bazuar në të gjeturat e cekura si më lartë e ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse në pension, tri pagave jubilarë dhe pagës së 13-të t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,975.00 €.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 të LPK - së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumë totale prej 259.00€ e që i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€, për përfaqësim në një seancë në shumë prej 135.00 € dhe për taksë gjyqësore prej 20.00€, gjithsej 259.00 €.

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.295/20, datë 18.03.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.